

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

|         |                                                                                                                                                                                 |
|---------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| TITULLI | Haga, midis maktheve dhe paranojave                                                                                                                                             |
| ADRESA  | <a href="https://www.gazetatema.net/blogu-tema/haga-midis-maktheve-dhe-paranojave-i585498">https://www.gazetatema.net/blogu-tema/haga-midis-maktheve-dhe-paranojave-i585498</a> |
| BURIMI  | gazetatema.net                                                                                                                                                                  |
| GJENDJA | online                                                                                                                                                                          |

## KOHA


|                       |                                                                                                                                                           |
|-----------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| KAPUR NGA NE          | 11 shtator 2026, 19:25:30 UTC<br><i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>                            |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 11 shtator 2026, 19:25:40 UTC<br><i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i> |

## HASH-ET · SHA-256

|            |                                                                  |
|------------|------------------------------------------------------------------|
| PËRMBAJTJA | e96f32668c6ee51198789705d0b66ce7b50dbadc2ae46fec9c4f6b53011a733a |
| TEKSTI     | 3cbfe828bbd9d2730dd9a7b6226a0c438fb3f9a93ea7c7f3478b939cedb48f4c |
| PAMJA      | 2572e6057ce875e5337a1a95eb8f033c7ab4ed9937acd7ccdded0e0b43c57c92 |

## ZINXHIRI I PROVËS

|               |                                                                                                                                                                    |
|---------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| KJO HYRJE     | 68bed656fcd5be0c21f2b3118e9f773ea5a7fc8639f70b78c7f3860a2f65559                                                                                                    |
| E MËPARSHMJA  | —                                                                                                                                                                  |
| RRËNJA MERKLE | —                                                                                                                                                                  |
| ANKORIMI      | nuk është ankoruar ende<br><i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i> |



## SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/68bed656fcd5be0c21f2b3118e9f773ea5a7fc8639f70b78c7f3860a2f65559>

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

English

Built and Monetized by  
[Kontakt](#)

English

1e Haga, midis maktheve dhe paranojaveSulmohet tubacioni i naties në Arabine Saudite, shpërthejnë zjarre në disa pikaNesër në Apolloni të Fierit, Gjergj Luca hap kompleksin e trete Fish City në S fundit

## Haga, midis maktheve dhe paranojave

11 Shtator 2026, 21:25Blog TEMA



Haga, midis maktheve dhe paranojave

Nga Kristaq Xharo

**Një akuzë për të mbrojtur akuzën.** Përpara datës 16 shtator, kur do të shpallet vendimi i gjykatës, prokurori ngriti një akuzëtë re. Ndjesia që të jep akuza e ngritur dje nga Haga kundër ish-drejtimesve të UÇK-së duket si makth dhe paranojë njëherësh. Makthi është frika se ajo që ke ndërtuar për vite e vite mund të shembet sapo të hapësh sytë. Po paranoja? Frika se çdo zë, çdo kujtim dhe çdo hije po komploton kundër teje. Dhe duket se të dyja, makthi dhe paranoja, takohen në të njëjtën sallë gjyqi: në Hagë.

Ndërkohë, ky nuk është një proces dosjesh të ftohta. Për shqiptarët, është gjyqi i shekullit. Në bankën e të akuzuarve janë katër njerëz, por pas tyre qëndrojnë një luftë, një rezistencë dhe një pjesë e historisë sonë. Prandaj pyetja nuk është vetëm se çfarë po ndodh në Hagë, por edhe: *çfarë vjen pas Hagës?*

Pas vitesh hetimesh, mijëra faqesh dhe qindra dëshmish, të akuzuarit po shfaqen përsëri si kërcënim. Jo vetëm si palë ndaj së cilës Prokuroria duhet të provojë akuzën, por tashmë edhe si makthi prej të cilit kërkohet të mbrohet vetë akuza. Këtu ironia nuk troket; hyn pa leje.

**Akuza që denoncon veten...** Akuza e re po ngrihet pranë së vjetrës si një patericë për të mbajtur një mur që lëkundet, si një hendek për të ruajtur murin dhe, ndoshta, nesër si një mur tjetër për të mbrojtur hendekun. *Nëse akuza është kaq e fortë, përse i duhen kaq shumë mure?* Për vite dëgjuam për dëshmitarë të mbrojtur, identitete të fshehura, seanca të mbyllura, masa sigurie, kontrolle dhe protokolle. Një fortesë e tërë u ngrit përreth tyre. Tani na thuhet se të akuzuarit i paskan kapërcyer këto mure. Nëse kjo tezë qëndron, lind vetvetiu pyetja: e kujt ishte përgjegjësia?

**Paradoksi tashmë nuk pëshpërit; ai vetakuzon.** Nëse të izoluarit nuk paskan qenë vërtet të izoluar dhe dëshmitarët nuk paskan qenë mjaftueshëm të mbrojtur, përse vlejten gjithë ato vite izolim, nëse sot vetë Haga na thotë se izolimi nuk mjaftoi? Edhe sikur kjo akuzë të gjente një alibi juridike, ajo do të kërkonte dy të pandehur: të izoluarit në sallë dhe vetë Hagën. Duke pretenduar se barrierat e burgut u kapërcyen, institucioni ngre njëkohësisht pikëpyetje mbi protokollin me të cilat përligji vite paraburgimi nën arsyen e mbrojtjes së dëshmitarëve. Akuza synon të rëndojë mbi të burgosurit, por hijja e saj bie edhe mbi institucionin që kishte për detyrë t'i ruante ato barrierat.

**Makthi pas mureve të çara.** Për akuzën bazë, të ndryshuar disa herë, u dëshën vite hetimesh, mijëra dokumente dhe rindërtimi i një skenari për një luftë të ndodhur dekada më parë. U kërkua edhe ndihma e Beogradit, i cili nuk nguroi të afrohej me çfarë kishte në duar. Ndërsa akuza e re u ngrit me një ngutje tjetër. Mos vallë Haga vrapon më shpejt kur makthi troket në derën e vet?

Dhe cili është makthi? Që muret e akuzës bazë kanë nisur të çahen dhe themelet të lëkunden? Që po bien, njëri pas tjetrit, gurët e vendosur që nga rrëfimi i “Shtëpisë së Verdhë”, nga teza e “ndërmarrjes së përbashkët kriminale” dhe nga përpjekja për të vendosur në të njëjtën peshorë pushtuesin dhe rezistencën?

Paradoksi mbetet fortesa e akuzës, mbi të cilën procesi ka hapur gjithnjë e më shumë pikëpyetje. Kur një mur nis të çahet, mjeshtri ka dy mundësi: të kontrollojë themelet ose të ndërtojë një tjetër përpara tij. Dhe këtu lind pyetja: mos vallë Haga ka zgjedhur murin? A po ngrihet akuza e re si mur mbrojtës për akuzën e vjetër?

**Kur akuza i kërkon dëshmitarët në rresht.** Nëse kujtojnë atë që mbështet akuzën, kujtesa bëhet gur në murin e saj; kur kujtojnë ndryshe, nis të dëgjohet krisja. Avokatja SophieMenegon vendosi mbi tryezë pikërisht gurin që nuk hyn lehtë në mur: Mustafa, Bislim Zyrapi dhe “Dëshmitari 4”, sipas argumentimit të mbrojtjes, kanë pohuar para vetë ZPS-së se askush nuk kishte ndërhyrë tek ata. Atëherë, ku fshihet ndikimi? Mos vallë dëshmitari është i besueshëm vetëm kur kujtesa e tij marshon në drejtimin e Prokurorisë, ndërsa bëhet i dyshimtë sapo ndalet përpara portës së saj?

Nëse po, atëherë kemi nënvlerësuar fuqinë e një qelie në Hagë. Një njeri i izoluar, iurvejuar dhe i kontrolluar paska mundur të kalojë muret, kamerat dhe protokollin, të hyjë në kujtesën e njerëzve dhe t’ua rregullojë historinë. Edhe Franz Kafka do ta kishte zili një skenar të tillë. Haga duket se ka nevojë për një rrugëdalje nga ky sokak qorr.

**Këtu makthi shartohet me paranojën.** Nëse të akuzuarit heshtin, fshehin; nëse flasin, ndikojnë; nëse kujtojnë, manipulojnë. Dhe kur dikush kujton si ata, qenka ndikuar. Nëse historia nuk përputhet me akuzën, mos vallë fajin duhet ta ketë historia? Të akuzuarit idealë mbeten kështu ata pa zë, pa kujtesë dhe, mundësisht, pa hije.

**Fuqia e dëshmisë.** Përballë dëshmitarëve të mbuluar nga anonimiteti, me kode dhe identitete të fshehura, mbrojtja solli në sallë emra me peshë ndërkombëtare: Wesley Clark, James Rubin, Christopher Hill, Jock Covey, John Duncan dhe Michael Durkee. Ata nuk e njohën luftën nga korridoret e ftohta të Hagës. E panë nga afër, takuan drejtuesit e UÇK-së dhe vepruan në qendrat e fuqisë botërore ku merreshin vendime për fatin e luftës dhe të Kosovës. Dëshmia e tyre nuk ishte një pëshpërimë pas perdes; ishte një pjesë e historisë që hyri në sallë me emër, fytyrë dhe përgjegjësi.

Kur akuza e parë kërkon një të dytë për t'u mbrojtur, cila po mban cilën mbi ujë? Menegon, avokatja e njërit prej të akuzuarve, ia hoqi paradoksit petkun juridik dhe e la përballë pyetjes së vet: sipas argumentit të mbrojtjes, kërkohet një dënim i rëndë për biseda të zhvilluara në paraburgim, ndërkohë që jashtë mureve nuk u provua pasoja që pretendohet se synohet. Atëherë, çfarë po peshohet: pasoja që ndodhi apo frika se mund të kishte ndodhur? *A po kapet Haga, si i mbytur pas fijos së kashës, për ta mbajtur gjallë akuzën e vjetër?* Sepse fija e kashës, sado fort ta shtrëngosh, nuk bëhet litar.

**Gjyqi i shekullit.** Ka gjyqe që peshojnë fate njerëzish dhe ka gjyqe mbi të cilat rëndon pesha e një epoke. Ky është një prej tyre. Në Hagë nuk maten vetëm fajësia apo pafajësia e katër burrave; për shqiptarët, aty preket kujtesa e një populli që luftoi për të dalë nga robëria dhe për të hyrë në histori me emrin e vet. Prandaj çdo dëshmi, çdo heshtje dhe çdo vendim do të shkojë shumë përtej mureve të asaj sale. Sepse në Hagë sot nuk jehon vetëm fati i katër burrave; aty troket një shekull shqiptar përpjekjesh për liri, me plagët, sakrificat dhe kujtesën e tij.

Por historia nuk mbahet në paraburgim. Një ditë muret bien. Kamerat fiken. Dosjet mbyllen. Dhe atëherë askush nuk pyet më sa të larta ishin muret. Pyetja është **çfarë mbanin brenda?**

Dhe pas gjithë kësaj mbetet pyetja që, për shqiptarët, është më e madhe se vetë procesi: **Çfarë vjen pas Hagës?**

**\* Lektor për Marrëdhëniet Ndërkombëtare në UET (Prof. Dr/ kolonel R)**

 Lini një Përgjigje

Koment \*

Emër \*

POSTOJE KOMENTIN

[Haga, midis maktheve dhe paranojave](#)

21:00 Blog

[Parku i Liqenit me syte nga qielli dhe SPAK](#)

19:26 Blog

[Mbrojini fëmijët nga shkolla](#)

18:00 Blog / 3 komente

[A ka OSBE/ODIHR në Amerikë?](#)

17:40 Blog / 7 komente

[Shteti i leshit dhe Republika e Prokurorëve dhe Gjyqtarëve](#)

13:50 Blog / 16 komente

## [Ministrja që Rama po kërkon](#)

12:40 Blog / 14 komente

## [Demokracia, jo më si vlerë lirie](#)

12:30 Blog / 7 komente

## [Një telash më shumë për Partinë Demokratike](#)

19:10 Blog / 21 komente

## [Kur protesta nuk shqetëson pushtetin, por merr peng qytetarin](#)

18:28 Blog / 33 komente

## [Sikur Lana të mbyste bulevardin me baltë](#)

17:05 Blog / 8 komente

### Më të lexuarat

24 orët e fundit

Javën e fundit

### [PROFIL: Kush është ministri i ri i Brendshëm?](#)

10:40 Kronika / 69 komente

### [Genti Tare: SPAK bëri show me Igli Taren, e mbajti 6 orë ...](#)

10:50 Politika / 51 komente

### [Audiopërgjimi i Ahmetajt dhe akuzat për trafik armësh, qe...](#)

11:15 Politika / 68 komente

### [Besfort Lamallari largohet si ministër i Brendshëm, në ve...](#)

10:10 Politika / 22 komente

### [Nga ndërhyrja te Trump, te Samiti i NATO-s! Thaçi për Ram...](#)

11:30 Politika / 31 komente

### Blog Tema

#### [Haga, midis maktheve dhe paranojave](#)

21:25 Blog

#### [Haga, midis maktheve dhe paranojave](#)

21:00 Blog

#### [Parku i Liqenit me syte nga qielli dhe SPAK](#)

19:26 Blog

### Lajme ekskluzive!

Nëse doni të jeni i pari për t'u informuar mbi lajme ekskluzive, regjistrohuni më poshtë.

Ju mund të çregjistroheni në çdo moment.

 Powered by [Tomorrow.io](#)

TemA është një gazetë e përditshme e palidhur politikisht e botuar në Tiranë, Shqipëri në gjuhën shqipe. E themeluar në korrik 1999, TemA është një nga gazetat ditore më të vjetra në Shqipëri dhe aktualisht shet rreth 15,000 kopje ditore në mbarë vendin.



Built and Monetized by

- [Politika](#)
- [Kronika](#)
- [Editorial](#)
- [Blog](#)
- [Bota](#)
- [Sport](#)
- [Shëndeti](#)
- [Turizëm](#)
- [Sociale](#)
- [Ekonomia](#)
- [Antena](#)
- [Rajoni](#)
- [Kulturë](#)
- [Lifestyle](#)
- [Dossier](#)
- [Hi-Tech](#)
- [Kontakt](#)
- [Te dhënat personale](#)
- [Cookies](#)

Built and Monetized by

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.